



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 27 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048 me plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin nr.04/L-194, nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, nenet 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2024, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS NGA VITI 2023 NË VITIN 2024 DHE DESTINIMIN NË KATEGORI DHE PROGRAME TË CAKTUARA BUXHETORE

Neni 1

1. Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës të pashpenzuara në vitin 2023 në shumë 344,213.05€, e që janë tejkalim i të hyrave të planifikuara për vitin 2023, barten në vitin 2024 në programet dhe kategoritë ekonomike si në vijim:

Programet:

- Administratë Komunale.....	253,904.54 €
- Arsim.....	75,641.01 €
- Shëndetësi.....	14,667.50 €

Kategoritë ekonomike:

- Investime kapitale.....	303,904.54 €
- Komunali.....	40,308.51 €

2. Mjetet e cekura destinohen në kategorinë e caktuar ekonomike sipas specifikacionit i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 3

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-401/01-0033712/24
Podujevë, datë, 23 maj 2024



Kryetari i Kuvendit
Miri Hoxha

**Specifikacioni i projekteve të financuara nga mjetet vetanake,
nga viti 2023 në vitin 2024**

I - programi- Planifikim Hapsinor dhe Rregullativ - 66030

kodi funksional-0620

kodi I projek	kodi ekor	Përshkrimi	shuma
49281	30	Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Xhemail Mustafa" me infrastruktur percjellese	74,358.99
		Totali	74,358.99

II -Programi - Infrastruktur Publike -18165

kodi funksional-0451

kodi I projek	kodi ekor	Përshkrimi	shuma
40280	30	Ndërtimi i stacionit të udhëtarve	85,332.50
		Totali	85,332.50

III -Programi i Arsimit- nënprogrami -93120 - Arsimi fillor

kodi funksional-0912

kodi I projek	kodi ekor	Përshkrimi	shuma
51919	30	Ndërtimi i shkollës " Musli Dumoshi" në Dumosh	50,000.00
	132	Komunali	25,641.01
		Totali	75,641.01

IV - Programi - Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik-48005

kodi funksional-0411

kodi I pr	kodi ekor	Përshkrimi	shuma
I ri	30	Ndertimi i tregut të ri të qytetit	44,213.05
		Totali	44,213.05

V - Bujqësi-47005

kodi funksional-0421

kodi I pr	kodi ekor	Përshkrimi	shuma
I ri	30	Ndertimi i Parkut Industrial Bujqësor ne Sfeqel	50,000.00
		Totali	50,000.00

VI - Sherbimet e Shendetesise primare - 73300

kodi funksional-0721

kodi I pr	kodi ekor	Përshkrimi	shuma
	132	Komunali	14,667.50
		Totali	14,667.50

Kategorit ekonomike	Shuma
Paga	
Mallra e Shërbime	
Komunali	40,308.51
Subvencione	
Investime Kapitale	303,904.54
Gjithsejt të hyrat e bartura nga viti -2023 :	344,213.05

